# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-451812**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | E rëndë në Itali/ Ministri i Arsimit merr zarfin kërcënues me një plumb brenda, reagon Meloni: Këto akte f rikacake nuk kanë vend në demokraci |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/e-rende-ne-itali-ministri-i-arsimit-merr-zarfin-kercenues-me-nje-plumb-bren-i586652` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 10:25:18 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 10:20:13 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6220540a8240f40299c91ddde6bc771afa8d665b7de1137fb7dbf12239efe104` |
| TEKSTI | `afcfb5f8db6486dbae8bab12902f415a05ee69dd6bc7c5b266c8db166aa4a1c9` |
| PAMJA | `c9e77875720bcea1a9c6bfd633d398b9d24e346d863ce11c39c6c9cc193d9783` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4435871fe8bb5bc8c6d0a074eb8de74453cc1fc5c4b26241a86fb6441d5ce9dd` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `aa9e18560c1a0d5b17c6b891acdb8aec89255b460c70dcb766ecaf13d039759d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4435871fe8bb5bc8c6d0a074eb8de74453cc1fc5c4b26241a86fb6441d5ce9dd`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# E rëndë në Itali/ Ministri i Arsimit merr zarfin kërcënues me një plumb brenda, reagon Meloni: Këto akte frikacake nuk kanë vend në demokraci

TemA
17 Shtator 2026, 12:20Bota TEMA



Një zarf që përmbante një plumb dhe një letër me fraza kërcënuese është dërguar në Ministrinë e Arsimit të Italisë, në adresë të ministrit Giuseppe Valditara.

Zarfi është dorëzuar në ministri gjatë ditëve të fundit, ndërsa më 16 shtator është bërë denoncimi pranë Karabinierëve. Autoritetet italiane kanë nisur hetimet për të identifikuar autorët dhe për të zbardhur rrethanat e ngjarjes.

Pas publikimit të lajmit, ministri Valditara ka marrë mesazhe solidariteti nga drejtues të lartë të qeverisë dhe politikës italiane.

Kryeministrja Giorgia Meloni shprehu solidaritetin e saj dhe të qeverisë me ministrin, duke i cilësuar plumbin dhe letrën kërcënuese si akte frikësimi që “nuk kanë vend në një demokraci”.

Zëvendëskryeministri dhe ministri i Jashtëm, Antonio Tajani, tha se Valditara “nuk do të frikësohet” dhe se aktiviteti i qeverisë nuk do të ndalet përballë kërcënimeve dhe dhunës.

Solidariteti ndaj ministrit erdhi edhe nga ministri i Kulturës, Alessandro Giuli, i cili e cilësoi ngjarjen një akt të papranueshëm frikësimi.

Presidenti i Dhomës së Deputetëve, Lorenzo Fontana, dhe presidenti i Senatit, Ignazio La Russa, shprehën gjithashtu mbështetjen e tyre për Valditarën.

La Russa deklaroi se shpreson që autorët e kërcënimit të identifikohen sa më shpejt nga autoritetet kompetente.

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Studiuesit: Ndryshimet klimatike çuan në katastrofën e shembjes së malit në Nepal]

11:50 Bota

Trump: Irani kontaktoi drejtpërdrejt SHBA-në, dëshiron të arrijë një marrëveshje

10:50 Bota

[Von der Leyen prezanton planin e ri të sigurisë: Këshill Evropian, protokoll emergjence dhe më shumë kapacitete ushtarake]

10:30 Bota

[SHBA rrit normat e interesit për herë të parë në më shumë se tre vjet]

10:00 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.